



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 13.03.2023

Nr: 21

Ora: 10:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 30 TË SUBJEKTIT
“LËVIZJA BASHKË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia “Lëvizja Bashkë”, përfaqësuar nga z. Arlind Qorri

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 157, datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike ‘Lëvizja Bashkë’ me kryetar z. Arlind Qorri, me shkronjat nistore ‘Bashkë’, në zgjedhjet për organet vendore të datës 14 maj 2023”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 10, dhe 17 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia “Lëvizja Bashkë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 30 regj., datë 11.03.2023. Në mbledhjen e datës 13.03.2023, ora 10:00, pas relativitetit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 30 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 30, datë 11.03.2023, të paraqitur nga Partia “Lëvizja Bashkë”;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 14.03.2023, ora 9:00;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar